



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.261/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), paraqitur kundër Kryesuesit të KVV-së, Bilall Krasniqi në vendvotimin 1920x/03 në Prishtinë, për shkak të asistimit në votimit, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.261/2017, e datës 12.06.2017, e Lëvizjes Vetëvendosje(LVV), me seli në Prishtinë, lidhur me asistimin e vëzhguesit në qendrën e votimit 1920x/03 në Prishtinë.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së zgjedhjeve, me datën 11.06.2017, komisioneret e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në shkollën fillore “Nazim Gafurr” në qendrën e votimit 1920x/03 në Prishtinë, ka konstatuar se kryesuesi i këtij KVV –së, Bilall Krasniqi ka lejuar që vëzhguesit kanë asistuar për personat me nevoja të veçanta si dhe nuk e ka lajmëruar KKZ-në, që i mungon libri i votimit. Për këtë në kuptim të dispozitës së Rregullores Zgjedhore nr.09/2013, neni 15 par. 5.2, LPZ-së neni 94 dhe Rregullore Zgjedhore nr.09/2013, neni 10 pika 1, lejimi i vëzhgueseve në asistim për personat me nevoja të veçanta si dhe mos lajmërimi i KKZ-së, që mungon libri i votimit përbën shkelje të dispozitave ligjore të lartë cekura. Sipas kësaj, kryesuesi i KVV-së, ka lejuar vëzhguesit kane asistuar për personat me nevoja te veçanta si dhe nuk ka lajmëruar KKZ-në, që i mungon libri i votimit, ka bërë shkelje të dispozitës së Rregullores Zgjedhore nr.09/2013 neni 15par,5.2, LPZ-së neni 94 dhe Rregullorja Zgjedhore nr.09/2013 neni 10,pika 1.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse nga prova e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është kryer shkelja e pretenduar në ankesë, kjo dëshmohet edhe nga deklarata e Kryesuesit i KVV-së, të qendrës së vendvotimit 1920x/03, Bilall Krasniqi, i cili në dëshminë e deponuar me datën 13.06.2017 për PZAP-it, ka pohuar se nuk qëndrojnë pretendimet në ankesë për arsye se pas asistimit të personit me nevoja të veçanta të gjitha janë konstatuar në librin e votimit, në këtë qendër të votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nën 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.261 /2017 më datën 14.06.2017



Kryesues i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*